



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:199719

Datë: 09.12.2024

Numri i dokumentit: 06568948

E.nr.167/2022

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Riza Livoreka dhe sekretaren juridike Azemine Berisha, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit I. L. nga Hani i Elezit, të cilën e përfaqëson avokati Sh. C. nga Kaçaniku, rruga e "...", pnr , kundër debitorit Komuna e Hanit të Elezit -Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën e diferencën në pagën bazë, më datë 09.12.2024, mori dhe bëri përpilimin e këtij:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën E.nr.167/2022, të kreditorit I. L. nga Hani i Elezit, kundër debitorit Komuna Hani i Elezit-Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit-pagimin e pagave jubilarë dhe shpenzimeve të procedurës përmbimore.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.167/2022, të datës 29.09.2022, e ka lejuar përmbartimin sipas propozimit të kreditorit I. L. nga Hani i Elezit, kundër debitorit Komuna e Hanit të Elezit -Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën e diferencës në pagën bazë dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të Aktgjykimit C.nr.46/2021, i datës 31.05.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 29.09.2022, e ka urdhëruar Ministrin e Financave, Punës dhe Transferave -Thesarin e Kosovës, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 658.00€, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

I autorizuari i kreditorit , e ka njoftuar gjykatën se është bërë pagesa e shumës së kërkuar me propozim dhe ka kërkuar që të përfundohet procedura përbarimore. Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tijë, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66 par 4, të LPP-së. Me këtë dispozitë është paraparë se pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përbarimore, e në rastin konkret debitori e ka përmbush detyrimin gjykata e përfundoi procedurën përbarimore në këtë çështje përbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega në Kaçanik

E.nr.167/2022, më datë 09.12.2024

GJYQTARI

Riza Livoreka

Dërguar me datën 09.12.2024

Kreditorit 1x1

Debitorit 1x1